



N.SH. "Elektroni"
Pronar: Kushtrim Krasniqi
OK "N.SH. "Elektroni"
Rr/HaxhiZeka
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KPM-2012/08
Ref: 1301/201/KPM/ni

VENDIM

lidhur me aplikacionin për licencë të operatorit kabllor, "N.SH. "Elektroni"-Zhur-Prizren

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
1. Në bazë të Nenit 5 të Rregullores CIMC 2007/04, operatorët aktivë kabllor kanë qenë të obliguar të regjistrohen një muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje, ndërsa tre muaj më vonë kanë qenë të obliguar të aplikojnë për licencë të KPM-së.
2. Kandidati për operator kabllor "N.SH. Elektroni", ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operator kabllor më datën 20 dhjetor 2011.
3. Gjatë vlerësimit të aplikacionit, të "N.SH. Elektroni", është vërejtur se mungojnë disa dokumente dhe informacione. Prandaj, KPM i është drejtuar me shkrim, përmes një e-maili, kandidatit dhe ka kërkuar nga ai që ti dorëzoj informacionet shtese. Kandidati nuk ka arritur ti sjell informacionet e kërkuara.

Arsyetim

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
5. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja*".

6. Në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullës CIMC 2007/04 operatori kabllor “N.SH. Elektroni” nuk ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor.
7. Me Rregulloren për Distributum Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator kabllor. Prandaj KPM, vlerëson se një operator kabllor mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve nëse ai posedon marrëveshjet valide për ritransmetimin e atyre programeve.
8. KPM, vlerëson se “N.SH. Elektroni” nuk ka paraqitur aplikacionin në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04 si dhe me rregulloren për Marrjen e Licencës së KPM-së (CIMC 2009/02).
9. Prandaj, KPM-së vlerëson se në bazë të nenit 6 të Rregullores CIMC 2007/04 operatori kabllor “N.SH. Elektroni” nuk i ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

Vendim

10. Komisioni i Pavarur për Media, konkludon se “N.SH. Elektroni” ka aplikuar për licencë të KPM-së mirëpo nuk i ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve kabllore përmes sistemit kabllor në Zhur.
11. Komisioni i Pavarur për Media, vendos që operatorit kabllor “N.SH. Elektroni”, i cili planifikon të operojë në Zhur komuna e Prizrenit, t’i refuzoj kërkesën për licencën e KPM-së, për të ofruar përmes rrjetit kabllor, shërbime të programeve, për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve.
12. Komisioni i Pavarur për Media, vendosë që kandidati, “N.SH. Elektroni ka të drejtë dhe mundë të aplikojë përsëri në të ardhmen, për licencë të Operatorit Kabllorë, mirëpo duhet që të dorëzojë aplikacion të ri dhe te kompletuar në zyrën e KPM-së.

Lëshimi i Vendimit

13. Këtë vendim e lëshon KPM

Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media.



28.12.2012
data